



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12.Nr. 060/01-1635 dt. 12. 01. 2022

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Drenasit z.Milaim Hajdari, me dt. 19.01.2022 (E Mërkure) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Bordit të Drejtorëve të Komunës.

THËRRET
Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Betimi i antarës znj. Blerina Gashi antare e Kuvendit Komunal në Drenas nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës" (PDK), duke e zevëndësuar antarën e Kuvendit Komunal znj.Egzona Jetullahut.
2. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizua për vitin 2021
3. Plani i vjetor i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022
4. Plani i vjetor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2022
5. Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 12-400/01-65504,të dt. 23.12.2021.
6. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Kaltrina Dvorani.**
7. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Fitore Bytyqi**
8. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Besarta Elshani.**
9. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Erleta Gjoshi**
10. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Medina Hoxha-Hyseni.**

11. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Qendresa Bajraktari.**
12. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Mejreme Morina.**
13. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Rajmonda Hasi.**
14. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Hamide Gashi.**
15. Propozim Vendim për financimin e projektit Start-Up nga kategoria e subvencioneve **Mihane Hyseni.**
16. Propozim Vendim për formimin e komisionit për plotsim të ndryshimin e statutit Nr.12.-060/05-14928, të datës 30.04.2020,të Ndermarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” në Drenas.
17. Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënjes në Shfrytëzim të pronës së paluajshme të Komunës.
18. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar –Dhjetor 2021.
19. Lista e rreziqeve Komunale për vitin 2022.
20. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për për Arsim Kulturë Rini dhe Sport. për vitin 2021.
21. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2021 .
22. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Komiteti për Barazi Gjinore për vitin 2021.
23. Të ndryshme.

Drenas, 12.01.2022



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës**



Nr. _____ dt. _____ 2021

Bazuar në nenin 35. pika 35.4, 35. 5, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet ta nënshkruajnë betimin solemn si në vijim.

Unë, _____, "betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Drenasit (Gllogoc), në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë".

Vendi: Kuvendi Komunal Drenas.

Datë, _____

Emri dhe mbiemri i Anëtarit/es të Kuvendit të Komunës së Drenasi _____

Nr.ident. _____

Nënshkrimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c), nenin 65.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03L-040, nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 28.12.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Znj.Blerina Gashi**, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Glllogoc, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj.Egzona Jetullahi.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj.Blerina Gashi dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 20.12.2021, Nr.3492/2021, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit Komunal znj.Egzona Jetullahi, me rastin e dorëheqjes së saj, për arsye të emërimit në pozitën e Drejtoreshës në Drejtorin për Zhvillim Ekonomik.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar, se kandidatja e radhës është znj.Blerina Gashi.

Kandidatja e radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 28.12.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Glllogocit (Drenasit)
Kuvendi Komunal



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLLOGOC			
GLLLOGOC MUNICIPALITY			
Data: 11 01 22			
Nj. Org	Nomëri	Sh. 13	Vlera
12	052	1368	

KOMITETI KONSULTATIV PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË
KOMUNËN E DRENASIT

Publikon:

RAPORTIN VJETOR

Për periudhën:

Janar-Dhjetor 2021

Drenas, 2021

PËRMBAJTJA

I PJESA HYRËSE.....	4
Prioritetet përgjatë vitit 2021.....	5
II PJESA TEMATIKE.....	6
Mbledhjet e Realizuara & Aktivitete të rëndësishme.....	6
Mbledhja e parë.....	6
Mbledhja e dytë.....	7
Mbledhja e tretë.....	8
Mbledhja e katërt.....	10
Mbledhja e pestë.....	11
Mbledhja e gjashtë.....	12
III PJESA PËRMBYLLËSE.....	14
Konkluzione & Rekomandime.....	14
Objektivat e arritura & Rezultatet.....	14
Kufizime.....	15
Propozime për ndryshim & Rekomandimet për vitin 2022.....	16
Planet prioritare të Komitetit Konsultativ për PAK për vitin 2022.....	16
Foto nga aktivitetet e Realizuara.....	18

SHKURTESAT

KKPAK - Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara

PAK - Persona me Aftësi të Kufizuara

AK – Aftësi e Kufizuar

OJQ - Organizata Jo Qeveritare

DKA - Drejtoria Komunale e Arsimit

DKRS - Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport

DSHMS – Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

(I)

PJESA HYRËSE**PARATHËNIE**

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Drenasit, me qëllim të transparencës dhe me qëllim të informimit për punën dhe aktivitetet e realizuara, publikon këtë raport për të përmbledhur punën, aktivitetet dhe mbledhjet e mbajtura, gjatë vitit 2021.

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (KKPAK), si organ drejtues i ri institucional, është formuar për herë të parë në komunën e Drenasit në vitin 2019, dhe si i tillë, vepron në harmoni me “Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr. 05/2020, për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komitetit të Përhershme dhe Komiteteve të tjera në Komuna”. Përmes mbledhjeve të realizuara, anëtarët e Komitetit Konsultativ për PAK kanë shqyrtuar dhe diskutuar në hollësi detyrat dhe përgjegjësitë e veta, dhe kanë vënë disa prioritetë. Specifikisht, si qëllim prioritar i këtij komiteti është të sigurojë përmirësim të dukshëm në statusin dhe cilësinë e jetës së personave me nevoja të veçanta, duke nxitur dhe siguruar mundësinë që të gjithë personat me nevoja të veçanta në territorin e Komunës së Drenasit t’i gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, kjo gjithnjë në bashkëpunim të përhershëm me vet këta persona, me institucionet komunale, me OJQ-të që ofrojnë shërbime psiko-sociale, e veçmas me ato OJQ që ofrojnë shërbime me përfshirje të PAK.

Si çdo vit, për t’i arritur objektivat e synuara, Komiteti Konsultativ për PAK me fillim vit ka hartuar planin e punës dhe kalendarin për takime për vitin 2021, në bazë të të cilit dhe ka realizuar aktivitetet.

Sipas rregullativës së Kuvendit Komunal të Drenasit, Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, ka mbajtur gjashtë (6) mbledhje të rregullta, por jo vetëm. Përveq mbledhjeve të rregullta, ky komitet ka mbajtur afër dhjetë (10) takime të tjera konsultative, përmes të cilave janë konkretizuar ide dhe specifika në aspektin e përmirësimit të jetës së personave me nevoja të veçanta - në komunën e Drenasit. Mbledhjet formale, zakonisht ky komitet i ka mbajtur në zyrën pranë byfesë në Komunën e Drenasit, tryezat e rrumbullakëta në zyrën e bordit, kurse takimet tjera konsultative i ka zhvilluar në terren dhe sipas rastit. Ftesa për mbledhje u është dërguar anëtarëve dhe të ftuarve të tjerë (atëherë kur kishte), 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes.

Andaj, krahas asaj çfarë është paraparë në planin e punës, ky komitet ka identifikuar një sërë nevojash për ndryshim në të mirën e PAK. Nevoja për këto ndryshime, është identifikuar përmes takimeve me vet PAK dhe familjarë të tyre, me zyrtarë, drejtor të drejtorive komunale, përfaqësues të OJQ-ve, përmes hulumtimeve të realizuara, dhe të tjera aktiviteteve, ku dhe kemi arritur të nxjerrim disa rezultate të cilat më pas janë ngritur në formën e rekomandimeve (propozimeve për ndryshim) dhe janë diskutuar me digaster të ndryshëm. Pas diskutimit, bashkërisht jemi dakorduar që këto rekomandime të shërbejnë si përpjekje për ndryshim në vitin 2022.

Prioritetet përgjatë vitit 2021

Prioriteteve gjatë vitit 2021, kryesisht i paraprijnë rekomandimet e raportit vjetor të vitit 2020, të cilat janë ngritur për vitin pasues. Ndër të cilat janë:

- ♦ Të vazhdojmë bashkëpunimin me Institucionet Komunale të Drenasit, me qëllim të rritjes së involvimit të personave me nevoja të veçanta në procesin e vendimarrjes. Kjo përmes takimeve konsultative, në afatet kohore të harmonizuara me axhendat e institucioneve përkatëse.
- ♦ Bashkëpunimi me OJQ-të që veprojnë në komuna të tjera, dhe që shtrijnë aktivitete në aspektin e ofrimit të trajnimeve në ngritjen e kapaciteteve për persona me nevoja të veçanta dhe avancimin e tyre, si dhe dakordimi që në ta ardhmen, trajnime të tilla të realizohen edhe në Drenas.
- ♦ Bashkëpunimi me OJQ-të që përfaqësojnë persona me nevoja të veçanta, për t'i dëgjuar kërkesat dhe propozimet e tyre për Komunën e Drenasit, në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të caktuara të nivelit komunal të qeverisjes.
- ♦ Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave me homologë/ anëtarë të Komitetetve Konsultative për PAK nga komunat e tjera, me qëllim të informimit për përvojat pozitive në kuadrin ligjor, në zbatueshmërinë e tij, në organizimin dhe rolin e entiteteve të aftësisë së kufizuar në këto komuna, si dhe me pjesëmarrjen aktive të këtij komuniteti në rrjedhat shoqërore dhe jetën publike.
- ♦ Marrja e pikëpamjeve, kërkesave, propozimeve dhe kritikave të qytetarëve, që kryesisht kanë të bëjnë me investimet në ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës shkollore, rrugëve, trotuarëve, ofrimin e shërbimeve shëndetësore për PAK, gjithëpërfshirja e nxënësve, dhe përcjellja e prioritetëve të tilla tek akterët relevant.
- ♦ Shënimi i datave të veçanta për personat me nevoja të veçanta
- ♦ Realizimi i intervistave dhe/apo hulumtimeve në terren, mbi bazën e identifikimit të aspekteve prioritare që kanë të bëjnë me personat me nevoja të veçanta, dhe ngritja e rekomadimeve praktike mbi bazën e rezultateve.
- ♦ Hartimi i broshurave mbi ndërgjegjësimin e shkollave, institucioneve komunale, dhe shoqërisë në përgjithësi, mbi të drejtat e personave me nevoja të veçanta.
- ♦ Identifikimi e numrit të nxënësve me nevoja të veçanta të përfshirë në aktivitetet, kurset dhe trajnimet në Akadaminë “Flutura”, në Drenas dhe inkurajimi i kësaj qendre për përfshirje më të madhe të këtyre nxënësve dhe bashkëpunimi me shkollat për t'i evidentuar më lehtë nxënësit e tillë.
- ♦ Të monitorojmë gatishmërinë e kopshteve për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta, apo zbatimin e praktikës për t'i refuzuar ata gjatë paraqitjes së tyre në procesin e regjistrimit si pjesë e kopshtit.

(II)

PJESA TEMATIKE**MBLEDHJET E REALIZUARA & AKTIVITETE TË RËNDËSISHME**

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (KKPAK), ka mbajtur gjashtë mbledhje të rregullta, në periudhën Janar - Dhjetor 2021. Pothuajse të gjitha mbledhjet janë realizuar në kohën e paraparë me Planin e Punës, dhe këtë vit, për dallim nga viti i kaluar, ishim më shumë të përgaditur në menaxhimin e aktiviteteve si rezultat i impaktit të mundshëm nga pandemia Covid-19.

Si çdo vit, burimet e raportit vjetor të aktiviteteve të realizuara edhe për vitin 2021 janë ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjeve/takimeve të komitetit. Ky raport vjetor, pas miratimit nga anëtarët e komitetit, do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komunës së Drenasit.

Mbledhja e parë e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara**PROCESVERBAL**

Me datë: 22.02.2021

Me datën 22.02.2021 (e hënë), Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, ka mbajtur mbledhjen e parë, të rregulltë, në zyrën me xhama pranë byfësë, në objektin e Komunës së Drenasit.

Në këtë mbledhje të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e këtij komiteti: Shemsi Bërbatovci (kryesues), Ariana Isufi (Zëvendës kryesues), Arlindë Krasniqi (Anëtare), Jehona Abdyli (Anëtare) dhe Burim Fazliu (Anëtar).

Mbledhja filloi në orën 13:30 dhe procesverbali është mbajtur nga Ariana Isufi.

Pikat e rendit të ditës ishin:

1. Raporti vjetor i punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, për vitin 2020
2. Miratimi i Planit të Punës së Komitetit Konsultativ për PAK për vitin 2021
3. Propozim për shënimin e datave të veçanta për PAK, në bashkëpunim me OJQ-të në Drenas
4. Identifikimi i Rrjetit të OJQ-ve të cilat shtrijnë aktivitete në fushën e trajtimit të PAK

- Bazuar në rendin e ditës, fillimisht kemi diskutuar lidhur me Raportin Vjetor të Punës për vitin 2020, se çfarë është realizuar, sfidat dhe çfarë ka rekomanduar ky raport përmbledhës i punës një vjeçare për vitin e ardhshëm.
- Pastaj për diskutim kemi kaluar tek pika e dytë e rendit të ditës, që ka të bëjë me miratimin e planit të punës për vitin 2021, ku kemi radhitur bashkërisht disa prioritet me rëndësi.
- Lidhur me pikën e tretë, për propozimin e shënimit të datave të veçanta për PAK, kemi rekomanduar që ky aktivitet është më lehtë i realizueshëm, duke bashkëpunuar me OJQ-të që operojnë në këtë Komunë, apo edhe duke bashkëpunuar me Komitetet Konsultative për PAK nga komunat tjera.
- Kurse sa i përket pikës së katërt, përkatësisht identifikimit të rrjetit të OJQ-ve në Drenas që shtrijnë aktivitetet për PAK, kemi parë të rëndësishme bashkëpunimin në mënyrë që të identifikojmë sfidat dhe nevojat e këtyre personave nga afër, dhe pa përfshirë asnjë OJQ.

Meqenëse nuk kishte ndonjë pikë tjetër për diskutim, me kaq mbledhja e parë e KKPAAK përfundoi, duke shpresuar në realizimin e aktiviteteve për mbledhjet e ardhshme. Mbledhja u mbyll nga procesmbajtësi - Ariana Isufi, në orën 15:00.

Mbledhja e dytë e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara

PROCESVERBAL

Me datë: 19.04.2021

Me datën 19.04.2021 (e hënë), Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, ka mbajtur mbledhjen e dytë, të rregulltë, në zyrën pranë zyrës në xhami në komunë.

Në këtë mbledhje të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e këtij komiteti: Ariana Isufi, Arlindë Krasniqi, Burim Fazliu, Jehona Abdyl dhe Shemsi Bërbatovci.

Mbledhja filloi në orën 13:20 dhe procesverbalit është mbajtur nga Ariana Isufi.

Të ftuar kishim edhe drejtorin e DKA – së, z. Muhamet Gjoka, por meqë drejtori në fjalë e kishte të pamundur pjesëmarrjen në takim, kemi filluar me pikat e rendit të ditës, për t'i diskutuar bashkë.

Pikat e rendit të ditës ishin:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së fundit, të datës 22.02. 2021

2. Ndërgjegjësimi i nxënësve në shkolla, mbi diskriminimin dhe paragjykimet ndaj bashkëmoshatarëve me nevoja të veçanta apo me AK.

3. Nxitja e fushatave ndërgjegjëse mbi informimin e prindërve, familjeve, shoqërisë, dhe institucioneve përgjegjëse, për të drejtën e fëmijëve me AK për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, në të njëjtat kushte me shokët e tjerë, si dhe ç'rënjosja e izolimit të fëmijëve me AK, si rezultat i mentalitetit aktual.

4. Të ndryshme

- Lidhur me pikën e parë, kemi diskutuar mbi mbledhjen e kaluar, me ç'rast kanë mbetur edhe disa aktivitete të analizohen dhe modifikohen në Planin e Punës për vitin 2021
- Sa i përket pikës së dytë, kemi planifikuar të realizojmë disa ligjerata në shkollat fillore të Komunës së Drenasit, lidhur me vetëdijësimin dhe ndërgjegjësimin e nxënësve mbi paragjykimet, etiketimet dhe diskriminimin që i bëhen nxënësve me nevoja të veçanta apo me AK, nga bashkëmoshatarët e tyre në shkolla.
- Dhe, në pikën e tretë, gjithashtu kemi planifikuar që në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të identifikojmë nxënësit më AK të cilët mbeten të izoluar në shtëpi apo që nuk përfshihen në institucionet edukative sikurse bashkëmoshatarët e tjerë, si dhe të mirren masat e duhura nga KKPAK, brenda përgjegjësisë për të parandaluar këtë fenomen negativ në shoqëri.

Pas këtij diskutimi, mbledhja u mbyllë nga procesmbajtësi Ariana Isufi, në orën 15:00.

Mbledhja e tretë e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara

PROCESVERBAL

Me datë: 17.06.2021

Me datën 17.06.2021 (e enjte), Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, ka mbajtur mbledhjen e tretë, të rregulltë.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin të gjithë anëtarët e këtij komiteti, gjegjësisht: Ariana Isufi, Arlindë Krasniqi, Burim Fazliu, Jehona Abdyli dhe Shemsi Bërbatovci.

Gjithashtu, pjesë e këtij takimi ishte edhe drejtori i DKA-së - Muhamet Gjoka, i cili na është bashkangjitur ndërkohë.

Mbledhjen e filluam në orën 13:25 në zyrën me xhama pranë byfësë, në komunë, kurse procesverbali është mbajtur nga Ariana Isufi.

Pikat e rendit te diës ishin:

1. Hartimi i Planit individual të Arsimit (PIA), në institucionet parashkollore dhe shkollat fillore të komunës së Drenasit, për ata nxënës me nevoja të veçanta që u mungon ky plan, duke ju referuar që dhënave të nevojshme për këta fëmijë
2. Identifikimi i nxënësve me nevoja të veçanta që kanë nevojë për sigurimin e transportit shtëpi-shkollë dhe anasjelltas.
3. Diskutim mbi mundësinë e furnizimit me mjete didaktike dhe konkretizuese në Dhomën Burimore në Komoran
4. Të ndryshme

- Meqenëse nga mbledhja e kaluar kanë mbetur disa çështje pa i diskutuar me drejtorin e DKA-së, në këtë takim jemi dakorduar për një bashkëpunim më të madh, në aspektin e ligjeratave në shkolla për ndërgjegjësimin e nxënësve në shkolla, mbi paragjykimet dhe etiketimet e nxënësve me nevoja të veçanta në shkolla.
- Lidhur me pikën e parë - kemi shtruar kërkesën tonë për nevojën e hartimit të këtij plani veçmas për fëmijët e institucioneve parashkollore, ku edukatorët e kanë të pamundur punën me këta fëmijë teksa u mungon plani PIA. Drejtori i DKA-së ka vlerësuar të dobishme këtë hap dhe do të bëj përpjekje së bashku me ekipën vlerësuese, që këta fëmijë të marrin shërbimet e nevojshme perkitazi me nevojat e tyre në këtë drejtim. Gjithashtu, edhe drejtori i DKA-së ka potencuar se ka rritje në nivelit të angazhimit të Psikologut në këtë drejtim.
- Sa i përket pikës së dytë – transportit për nxënësit me NV, drejtori i DKA-së ka potencuar se si DKA kanë treguar interesim edhe vitin e kaluar për sigurimin e transportit për këta nxënës, por siç duket nuk kishte nxënës të interesuar, prindër apo mësimdhënës për të parashtruar një kërkesë të tillë, andaj, ne si KKPAK- kemi rekomanduar që para shtatorit të identifikojmë me nr. këta nxënës që kanë nevojë për transport, dhe të ua bartim listën DKA-së për hapa të mëtejshëm. Megjithatë, një arsye tjetër në diskutim e sipër lidhur me transportin për nxënësit me NV, ishte se kompanitë e transportit nuk kishin aplikuar për ta marrur këtë përgjegjësi për shkak se pagesën e kanë vlerësuar të ulët, kurse për të ardhmen e afërt DKA ka rritur kosoton e pagesës që me i motivu kompanitë me apliku.
- Lidhur me pikën e tretë - kemi propozuar një takim të përbashkët me koordinatoren e Dhomës Burimore në Komoran, drejtorin e shkollës “Xheladin Gashi-Plaku” në Komoran, me drejtorin e DKA-së si dhe neve si KKPAK, në mënyrë që të shohim mundësitë mbi kërkesat për furnizim me këto mjete.

Meqenëse nuk kishte pikë tjetër për diskutim, mbledhja u mbyll nga procesmbajtësi- Ariana Isufi, rreth orës 15:10.

Mbledhja e katërt e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara

PROCESVERBAL

Me datë: 26.08.2021

Me datën 26.08.2021 (e enjte), Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, ka mbajtur mbledhjen e katërt, të rregulltë.

Në mbledhje morën pjesë të gjithë anëtarët e këtij komiteti, gjegjësisht: Ariana Isufi, Arlindë Krasniqi, Burim Fazliu, Jehona Abdyli dhe Shemsi Bërbatovci.

Mbledhja është mbajtur në zyrën pranë byfësë në Komunë dhe diskutimi lidhur me pikat e rendit të ditës ka filluar në orën 09:20-10:40. Procesverbali është mbajtur nga Ariana Isufi.

Pikat e rendit të ditës ishin:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit (të rregulltë), të datës: 17.06.2021
 2. Diskutim mbi identifikimin e kërkesave që shkollat kanë përkitazi me nevojat e nxënësve me nevoja të veçanta, përfshirë mësimin në kohë pandemie, mjetet e punës, transportin etj
 3. Konkretizimi i ideve dhe përvojave mbi realizimin e hulumtimeve me tema të nevojshme dhe aktuale, lidhur me përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla dhe më gjerë
 4. Planifikimi i hartimit të broshurave me fokus PAK, e veçmas fëmijët, kjo pas identifikimit të fenomeneve negative për këtë kategori
 5. Të ndryshme
- Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës, gjegjësisht miratimin e procesverbalit të mbledhjes së fundit, kemi bërë një analizë të kërkesave tona tek persona kompetent mbi ofrimin e shërbimeve të nevojshme për PAK, dhe kemi planifikuar të monitorojmë apo përcjellim realizimin e kërkesave në fjalë.
 - Sa i përket pikës së dytë, dy anëtarët e komitetit në fjalë vetëm sa kanë shpalosur disa nga vështirësitë që kanë identifikuar në shkollat ku punojnë, gjegjësisht ishin anëtarët Shemsiu dhe Jehona ata që filluan diskutimin në këtë aspekt. Por gjithashtu, për t'u informuar më saktë ne kemi planifikuar që të mbajmë kontakte të rregullta virtuale, por edhe vizita në shkolla.

- Lidhur me pikën e tretë do të analizojmë mundësitë nëse hulumtimet e planifikuara në shkollë, OJQ, apo edhe në institucione të tjera do të realizohen online apo me prezencë fizike, etj.
- Në pikën e katërt, ne kemi planifikuar hartimin e broshurave, por vetëm atëherë kur të identifikojmë ato dukuri të cilat konsiderohen shqetësuese për komunitetin e PAK, dhe të cilat do të shprëndahen për rritjen e vetëdijësimit dhe ndërgjegjësimit për mbarë komunitetin.

Procesmbajtësi Ariana Isufi, ka konsideruar të përfunduar mbledhjen, meqenëse asnjë nga anëtarët nuk kishin dicka më shumë për të diskutuar. Takimi ynë përfundoi në orën 10:40.

Mbledhja e pestë e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara

PROCESVERBAL

Me datë: 08.10.2021

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK) në Drenas, ka mbajtur mbledhjen e pestë dhe të rregulltë, me radhë, me datën 08.10.2021 (e Premte).

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin të gjithë anëtarët e këtij komiteti: Ariana Isufi, Arlindë Krasniqi, Burim Fazliu, Jehona Abdyli dhe Shemsi Bërbatovci.

Si zakonisht mbledhjen e kemi mbajtur në zyrën në xhami pranë byfësë në Komunë dhe diskutimi lidhur me pikat e rendit të ditës ka filluar në orën 13:15. Procesverbali është mbajtur nga Ariana Isufi, e cila edhe ka filluar me diskutimin.

Pikat e rendit të ditës ishin:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit (të rregulltë), të datës: 26.08.2021
2. Ndërmjetësimi nga ana e KKPAK në mes PAK, OJQ-ve të ndryshme dhe institucioneve të tjera, në aspektin e ofrimit të shërbimeve për sigurimin e pajisjeve të ndryshme dhe kërkesave të tjera që kanë PAK, kundrejt këtyre institucioneve
3. Bashkëpunimi me OJQ-të jo qeveritare, në nivel lokal dhe qendror, në aspektin e ofrimit të trajnimeve në ngritjen e kapaciteteve për PAK dhe avancimin e tyre në Drenas.
4. Bashkëpunimi me shkollat në aspektin e identifikimit të vështirësive në qasje të barabartë, mësim cilësor, gjithëpërfshirje dhe sigurimin e transportit për nxënësit me nevojë të veçanta.
5. Të ndryshme

- Sa i përket pikës së parë, kemi parë që për shkak të shtyerjes së mësimimit nga pandemia Covid-19, nuk janë realizuar vizita në shkolla nga KKPAAK, por gjithsesi kemi shërbyer si urë lidhëse në mes të institucioneve të ndryshme dhe PAAK.
- Lidhur me pikën e dytë, ne kemi adresuar nevojat dhe kërkesat e natyrave të ndryshme të PAAK tek institucionet, sikur që janë OJQ-të, përkatësisht HANDIKOSI, për sigurimin e karrocave dhe pajisjeve të tjera që ndihmojnë këta persona, nga ku kjo e fundit, pra HANDIKOSI, ka reflektuar pozitivisht dhe ka ndihmuar PAAK.
- Sa i përket pikës së tretë të rendit të ditës, ne kemi bashkëpunuar me organizata në nivel lokal dhe ato OJQ që shtrijnë aktivitete në komuna të tjera në aspektin e shkëmbimit të ideve dhe përvojave për të sjellur benefite për PAAK, ndër të tjera kemi konstatuar se komuna jonë ka nevojë primare në avancimin e PAAK dhe ngritjen e kapaciteteve.
- Pika e katërt kërkon nga ne që në muajin tetor të përfundojmë me listimin e nxënësve me nevoja të veçanta në shkolla, që kanë nevojë për transport, kurse lidhur me identifikimin e vështirësive të tjera, ne anëtarët jemi dakorduar njëzëri që të vazhdojmë edhe me vizita në shkolla, për muajt e ardhshëm.

Meqenëse nuk kishim pika të tjera për diskutim, zv. kryesuesi dhe njëherish procesmbajtësi Ariana Isufi, ka konsideruar të përfunduar mbledhjen, Takimi ynë përfundoi në orën 15:00.

Mbledhja e gjashtë të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara

PROCESVERBAL

Me datë: 01.12.2021

Mbledhja e gjashtë e rregulltë e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAAK) në Drenas, është mbajtur me datën 01.12.2021 (e Mërkure).

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij komiteti: Ariana Isufi, Arlindë Krasniqi, Burim Fazliu, Jehona Abdyli dhe Shemsi Bërbatovci.

Kësaj here mbledhjen e kemi mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit, me fillim nga ora 14:15. Procesverbali është mbajtur nga Ariana Isufi, e cila edhe ka filluar me diskutimin.

Pikat e rendit te ditës ishin:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit (të rregulltë), të datës: 08.10.2021
2. Bashkëpunimi me akademinë “Flutura”, për të parë përfshirjen në kurse dhe trajnime të fëmijëve (nxënësve) me nevoja të veçanta
4. Takime me mësues mbështetës në shkolla, për të parë bashkëpunimin e ndërsjelltë me mësindhënës, prind dhe nxënësit, lidhur me hartimin e planit PIA për nxënësit me aftësi të kufizuara
3. Publikimi i broshurës së hartuar nga KKPAK mbi ndërgjegjësimin e të drejtave të PAK, për datën 3 Dhjetor, në ditën ndërkombëtare të PAK
5. Të ndryshme

- Sa i përket pikës së parë, rezultati i aktiviteteve tona nga mbledhja e kaluar është se kemi lidhur bashkëpunim me organizatën Qendra Kosovare për Vetë-Përkrahje (QKVP), e cila vepron në Prishtinë, ka premtuar se do të vazhdoj me projekte, ku në të ardhmën pjesë e projekteve do të jenë PAK nga Drenasi.
- Lidhur me pikën e dytë, qendrës “ Flutura Academy”, do të ua rekomandojmë që të përfshijë në kurse dhe trajnime, më shumë nxënës me aftësi të kufizuara, varësisht nga të dhënat që do të sigurojmë nga kjo qendër.
- Sa i përket pikës së tretë të rendit të ditës, kemi rekomanduar njëzëri që të identifikojmë apo evidentojmë barrierat në komunikim mes palëve, të cilët i kontribuojnë planit PIA për nxënësit me nevoja të veçanta, dhe do ti japim rekomandimet e nevojshme, apo do të sigurohemi që ndërmjetësimi ynë të jetë i efektshëm në këtë drejtim.
- Pika e katërt, broshura të cilën e kemi hartuar për ndërgjegjësimin për të drejtat e PAK, do ta shpërndajmë me shkollat dhe institucione të tjera, si dhe me qytetarë, në Ditën Ndërkombëtare të PAK, me 3 Dhjetor, si kampajnë vetëdijësuese.

Meqenëse nuk kishim pika të tjera për diskutim, zv. kryesuesi dhe njëherish procesmbajtësi Ariana Isufi, ka konsideruar të përfunduar mbledhjen, në orën 15:15.

(III)

PJESA PËRMBYLLËSE

KONKLUZIONE & REKOMANDIME

Komiteti duke parë rëndësinë e bashkëpunimit dhe nxitjen e tij në realizmin e objektivave të veta, ka siguruar bashkëpunim institucional për PAK, nëpërmjet shkëmbimit dhe ndarjes së informacionit dhe praktikës më të mirë. Ky raport është një sinjal i qartë se mbi bazën e aktiviteteve tona, kemi hipotetizuar e ngritur objektiva konkrete, kemi aranzhuar takime e vizita në terren me akter të ndryshëm, kemi identifikuar problematika, kemi parë nevojën për ndryshim dhe arritur rezultate konkrete. Andaj, sipas kësaj logjike, kemi ardhur në përfundim mbi nevojën e ngritjes së disa rekomandimeve praktike, të cilat i kontribuojnë nevojës për ndryshime.

Objektivat e Arritura & Rezultatet

- ♦ Në aspektin e përgjithshëm kemi arritur që në përpikmëri t'i përmbahemi Udhëzimit Administrativ, në harmoni me të cilin veprojmë lidhur me realizmin e punës dhe aktiviteteve tona. Kjo gjithmonë duke e mbajtur të informuar zyrën e Kuvendit Komunal me procesverbalet e mbledhjeve, raportet tre mujore si dhe në takimet e realizuara me kryesuesin e Kuvendit Komunal.
- ♦ Gjithashtu, objektivë kryesore ka qenë t'i përmbahemi me përpikmëri Planit të Punës, për vitin 2021, dhe nga aktivitetet e realizuara, rezulton se pothuajse të gjitha janë arritur në kohën e planifikuar.
- ♦ Vizita dhe bashkëpunimi me Qendrën e Shëndetit Mendor në Drenas, dhe informimi lidhur me shërbimet psiko-sociale dhe shëndetësore që ofron kjo qendër për klientët/pacientët brenda saj, si dhe dakordimi mes KKPAK dhe kësaj qendre që të shtrijnë aktivitete të përbashkëta edhe me OJQ – të tjera, për të mirën e PAK në të ardhmen.
- ♦ Monitorimi i shkollave, gjegjësisht mësimdhënësve lidhur me shfrytëzimin apo përdorimin e udhëzuesit të hartuar në vitin 2020 nga KKPAK lidhur me mësimin në distancë për nxënësit me nevoja të veçanta, për aq kohë sa mësimi është realizuar online.
- ♦ Bashkëpunimi me Komitetin Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe bashkëdyzimi i ideve mbi dhënjen e kontributit të përbashkët lidhur me personat me nevoja të veçanta, në aspektin e kulturës, rinisë dhe sportit.
- ♦ KKPAK për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të PAK si datë të rëndësishme, ka shtuar fokusin të veçantë në hartimin e një broshure, me titull “Edhe Unë Kam Ëndërra, Dua Të Lulëzoj Në Mesin Tuaj”, qëllimi i së cilës broshurë është të nxisë që të gjithë PAK të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si dhe të nxisë respektin për

dinjitetin e tyre. Andaj, kjo broshurë është ndarë me drejtor, mësime dhënë, nxënë, si dhe është vazhduar me shpërndarjen e tyre në qytet, si kampanjë vetëdijësuese, për nder të kësaj dite.

♦ Kemi organizuar dhe realizuar takime online me Komitetet Konsultative funksionale për PAK të komunave të ndryshme, nga ku kemi diskutuar dhe shkëmbyer sfidat e përbashkëta, përvojat dhe arritjet e deritanishme.

♦ Bashkëpunimi me akademinë “Flutura” për të trajtuar nga afër përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta, në këto kurse dhe trajnime që ofron kjo qendër, Njëherish jemi dakorduar që KKPAAK të shërbej si urë lidhëse në këtë drejtim, ku do të ua rekomandoj shkollave, përkatësisht mësime dhënëse të identifikojnë në klasat e tyre, nxënësit me nevoja të veçanta të cilët konsiderojnë se kanë interes dhe potencialin e duhur për t’u përfshirë në këto aktivitete.

♦ Pas adresimit të kërkesës sonë në DKA, konsiderojmë se kemi kontribuar në angazhimin më të madh të ekipës vlerësuese rreth vlerësimit të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollë, dhe hartimit të planit PIA, në mënyrë që edhe shërbimet t’i marrin perkitazi me nevojat e identifikuar.

♦ Në bashkëpunim me OJQ “HANDIKOS”, në ekspozitat e realizuara, kemi përkrahur moralisht zhvillimin dhe përdorimin e potencialit të personave me nevoja të veçanta krijuese, artistike, dhe intelektuale, jo vetëm për të mirën e tyre, por gjithashtu për pasurimin kulturor të shoqërisë.

♦ Realizimi i tryezës së rrumbullakët, me theks të veçantë në fushën e arsimit, me profesionist të fushës, lidhur me shërbimet për fëmijët me nevoja të veçanta në Dhomën Burimore, në Komoran, si dhe identifikimi i nevojave për mjete konkretizuese dhe didaktike.

♦ Në bashkëpunim me OJQ “HANDIKOS”, kemi pranuar kërkesa dhe kemi arritur që t’u sigurojmë karroca dhe pajisje të tjera të nevojshme, personave me nevoja të veçanta.

♦ Kemi lidhur bashkëpunim me OJQ “Qendra Kosovare për Vet-Përkrahje, e cila ka shprehur gatishmëri që në të ardhmen e afërt të përfshijë në projektet e saj PAK në Drenas, dhe në këtë aspekt të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve dhe avancimin e PAK, si nevojë primare në këtë komunë.

Kufizimet

♦ Një nga kufizimet e aktiviteteve tona gjatë këtij viti, është se nuk kemi realizuar vizitat e planifikuara nëpër shkollë, për të parë nga afër shërbimet psiko-sociale dhe edukative që u ofrohen nga stafi i mësime dhënëse si dhe qasja e bashkëmoshatarëve ndaj tyre. Edhe pse në këtë drejtim, nuk ka munguar bashkëpunimi virtual apo komunikimi online me shkollat e komunës së Drenasit.

♦ Si kufizim tjetër për këtë vit, kjo për shkak të shtyerjes së mësimit me prezencë fizike në muajin shtator, si rezultat i pandemisë Covid-19, është identifikimi i nxënëseve me nevoja të veçanta që

kanë nevojë për sigurimin e transportit dhe bashkëpunimi me DKA-në për t'u avancuar në këtë drejtim.

Propozime për ndryshim & Rekomandimet për vitin 2022

- ♦ Inkurajojmë Institucionet Komunale që ta njohin dhe zbatojnë të drejtën e personave me nevoja të veçanta për të punuar, njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë duke marrë hapat e duhur, përfshirë masat ligjore.
- ♦ Inkurajojmë OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës së të cilave është i fokusuar e fushën shërbimeve psiko-sociale apo edhe kulturore, të aplikojnë për mbështetje financiare në Drejtoritë Komunale, që në thirrjet e tyre ofrojnë mundësi për ndarjen e granteve dhe subvencioneve përfshirë edhe fushën e PAK, ngase sipas të dhënave që posedojmë nga këto drejtori, aplikimet e tilla janë të vogla në numër. Gjithashtu, u rekomandojmë drejtorive përkatëse si DKRS dhe DSHMS, që të stimulojnë dhe inkurajonë këto organizata, të bëhen pjesë e organizimit të aktiviteteve të tilla, me anë të aplikimit përmes projektpropozimeve të tyre.
- ♦ Rekomandojmë DKA –në për angazhmin e psikologëve në shkolla, kjo ngase siç e dijm roli i tyre është i domosdoshëm dhe nuk zëvendësohet as me pedagog dhe as me profesionistë të tjerë të fushave të ngjashme.
- ♦ Inkurajojmë Drejtorinë e Infrastrukturës në identifikimin e gjitha pikave në trotuare ku nuk ka mundësi për lëvizje të lirë, dhe rekomandojmë rregullimin e trotuareve, pjerrinave në rrugë (qytet), për qasje më të lehtë të PAK.
- ♦ Në kuadër të Drejtorisë së Arsimit, përkatësisht në kuadër të kopshtit “Ardhmëria”, rekomandojmë zbatimin e ligjit për pranimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në kopsht, kjo ngase nga bashkëpunimi ynë me psikologun komunal, ky i fundit ka vërejtur mangësi dhe neglizhencë nga ky kopsht për pranimin e këtyre fëmijëve në afatet që lejon ligji përkatës.

Planet Prioritare të Komitetit Konsultativ për PAK për vitin 2022

- ♦ Realizimi i hulumtimeve me përfshirje kompanive private dhe bizneseve private, për të nxjerrur statistika të sakta nëse kanë të punësuar me AK.
- ♦ T'i inkurajojmë personat me nevoja të veçanta, gjithmonë duke shqyrtuar mundësitë për një ambient të përshtatshëm që të zhvillojnë dhe përdorin potencialin e tyre krijues, artistik, dhe intelektual, jo vetëm për të mirën e tyre, por gjithashtu për pasurimin kulturor të shoqërisë.
- ♦ Komiteti do të angazhohet në monitorimin aktiv të implementimit të legjislacionit për PAK, përmes takimeve mujore me institucionet, si dhe përmes bisedave joformale me zyrtarët e tyre.

Pjesë e këtij monitorimi do të jetë edhe zbatimi në praktikë i konkluzioneve dhe rekomandimeve të mbledhjeve të Komitetit.

♦ Shkëmbimi i përvojave me komitetet e komunave të tjera për PAK, për të dhënë ide, për të trajtuar problematikat dhe për të diskutuar për një orientim kundrejt mënyrave me efektive të përmirësimit dhe zgjidhjes sa më të mirë për PAK, si grup target në kuadër të aktiviteteve të Komitetit Konsultativ për PAK.

♦ Hartimi i Materialeve/ Broshurave vetëdijësuese, dhe publikimi i tyre, përveç fushatave ekzistuese, të cilat kanë impakt të zvogëlojnë mundësinë për të diskriminuar qytetarët në bazë të aftësisë së kufizuar.

♦ Komiteti Konsultativ për PAK do të angazhohet që institucionet e arsimit në nivel komunal, të garantojnë një sistem arsimor gjithëpërfshirës parauniversitar, duke u rekomanduar institucioneve që të marrin masat e duhura për këtë qëllim, duke përfshirë: Lehtësimin e të mësuarit të alfabetit Braille, lehtësimin e të mësuarit të gjuhës së shenjave si dhe trajnimin e stafit që punon në të gjitha nivelet arsimore komunale, trajnime të cilat duhet të përfshijnë ndërgjegjësimin në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe përdorimin e mënyrave të duhura augmentative/njohëse dhe alternative, mjeteve dhe formateve të komunikimit, teknikave edukuese dhe materialeve për të mbështetur personat me nevoja të veçanta.

Ky raport është shqyrtuar dhe miratuar nga anëtarët e Komitetit Konsultativ për PAK

Anëtarët e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara:

1. Shemsi Bërbatovci (kryesues)
2. Ariana Isufi (zëvendës kryesues)
3. Arlindë Krasniqi (anëtare)
4. Burim Fazliu (anëtar)
5. Jehona Abdyli (anëtare)



Foto nga mbledhjet e rregullta të mbajtura në vitin 2021- KKPAK DRENAS







Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 030/01- 66958 dt. 30.12. 2021

PLANI I PUNËS
SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN
2022

Dhjetor, 2021

PLANI I PUNËS

SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2022

Pasqyra e planit

Parathënie.....	02
Janar.....	05
Shkurt.....	06
Mars.....	07
Prill.....	08
Maj.....	09
Qershor.....	10
Korrik.....	11
Gusht.....	12
Shtator.....	13
Tetor.....	14
Nëntor.....	15
Dhjetor.....	16

Parathënie

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët. Punën dhe aktivitetin e vet e mbështet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale (LVL), Statutin e Komunës dhe akte të tjera nënligjore. Siguron kushte të punës për seanca të Kuvendit, si dhe pjesëmarrje për qytetarët gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve, për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe çdo gjë në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Kuvendi i Komunës nxjerr akte të rëndësishme për Komunën siç janë:

- Statuti i Komunës
- Rregullorja e Punës
- Rregulloret komunale dhe çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionim normal të komunës

Përveç këtyre akteve, Kuvendi i Komunës kryen edhe funksione të tjera dhe detyra të pa deleguara:

- Miraton Planin Vjetor të Punës
- Themelon komisione sipas ligjit
- Merr vendime për krijimin dhe përdorimin e dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi
- Bën emërimin, riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike
- Arrin marrëveshje ndër komunale dhe brenda komunale
- Merr vendime për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës, si dhe përgjegjësit të tjera të përcaktuara me ligj.

Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Drenasit për vitin 2022

Plani i punës së Kuvendit ka për qëllim planifikimin paraprak të punës për vitin 2022 dhe i bashkërenditur me aktivitetet e Planit të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2022. Plani i Punës e përmbledh punën një vjeçare të Kuvendit, duke përfshirë të gjitha punët dhe aktivitetet, ndërsa çështjet të cilat nuk mund të planifikohen dhe dalin si nevoja për shqyrtim në Kuvend, do të trajtohen sipas ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit të Komunës së Drenasit dhe Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit. Në këtë mënyrë, në Planin e Punës janë paraparë 11 mbledhje të rregullta që do të mbahen për vitin 2022, mbledhjet do të mbahen javën e fundit të çdo muaji, përjashtimisht në rast kur mund të përcaktohet ndryshe.

Planifikimi i mbledhjeve të KK –së dhe çështjet që do të trajtohen gjatë vitit 2022

Shtojcë: *Plani i punës sipas muajve*

PLAN I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2022
JANAR 2022

Nr	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETE T Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti vjetor i buxhetit për vitin 2021	DF	Kryetari i Komunës	12.01.2022	KPF 19.01.2022	26.01.2022	
2.	Raportet e Komiteteve Konsultative në KPF	Komitetet Konsultative	Kuvendi i Komunës	12.01.2022	KPF 19.01.2022	26.01.2022	
3.	Përgatitja e Rekomandimeve për Kuvend.		Kuvendi i Komunës				
4.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	12.01.2022	KPF 19.01.2022	26.01.2022	
5.	Përgatitja e procesverbaleve	Zyrtari/ja i /e zytës.		Mbledhjen e radhës			
6.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2022
SHKURT 2022

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti i Kryetarit të Komunës për vitin 2021.	Drejtoritë profesionale	Kryetari i Komunës	09.02.2022	KPF 16.02.2022	23.02.2022	17 shkurti Dita e pavarësisë
2.	Plani i veprimtimit për transparencë për vitin 2021.	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës		KPF 16.02.2022		
3.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës		KPF 16.02.2022		
4.							
5.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2022

MARS 2022

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend AKTIVITETET Afati kohor	
		Dytësor	Parësor				
1.	Plani i veprimit për transparence për vitin 2021	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	10.03.2022	KPF 17.03.2022	24.03.2022	5,6,dhe 7 Epojeja e UÇK 8,Mars, DNG
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	10.03.2022	KPF 17.03.2022	24.03.2022	
3.							
4.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2022

PRILL 2022

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti financiar për tre mujorin e vitit 2022	DF	Kryetari i Komunës	13.04.2022	KPF 20.04.2022	27.04.2022	Dita botërore e Tokës - 22 Prilli
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	13.04.2022	KPF 20.04.2022	27.04.2022	
3.							
4.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2022

MAJ 2022

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Informatat lidhur me qarkoren Buxhetore 2022 dhe planifikimi i veprimit për dëgjime Publike	DF	Kryetari i Komunitetit	12.05.2022	KPF 19.05.2022	26.05.2022	
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunitetit	12.05.2022	KPF 19.05.2022	26.05.2022	
3.							
4.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2022

QERSHOR 2022

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Draft – korniza afatmesme buxhetore (KAB) për vitet 2022-2024	DF	Kryetari i Komunës	15.06.2022	KPF 22.06.2022	29.06.2022	
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	15.06.2022	KPF 22.06.2022	29.06.2022	
3.							
4.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2022

KORRIK 2022

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti gjashtë mujor i Kryetarit të Komunës së Drenasit për vitin 2022	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	13.07.2022	KPF 20.07.2022	27.07.2022	
2.	Raporti i Auditorit të Jashtëm për vitin 2022 për Komunën e Drenasit (Glllogocit)		Kryetari i Komunës				
3.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës				
4.							
5.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2022

GUSHT 2022

- Muaji i pushimeve verore

PLAN I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2022

SHTATOR 2022

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti gjashtë mujor financiar i Komunës së Drenasit për vitin 2022	DF	Kryetari i Komunës	14.09.2022	KPF 21.09.2022	28.09.2022	
2.	Shqyrtimi i Draft -Buxhetit final, dhe marrja e vendimit për buxhet për vitet 2022-2024	DF	Kryetari i Komunës	14.09.2022	KPF 21.09.2022	28.09.2022	
3.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtorit profesionale	Kryetari i Komunës	14.09.2022	KPF 21.09.2022	28.09.2022	
4.							
5.							
6.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2022

TETOR 2022

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETE T Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti nëntë mujor i realizimit të buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2022	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	12.10.2022	KPF 19.10.2022	26.10.2022	
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	12.10.2022	KPF 19.10.2022	26.10.2022	
3.							
4.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2022

NËNTOR 2022

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Informatë nga Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsimit rreth realizimit të përfundimit të projekteve kapitale në teren	Drejtorië	Kryetari i Komunës	10.11.2022	KPF 17.11.2022	24.11.2022	28. Nëntor 2021. Dita e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtorië	Kryetari i Komunës	10.11.2022	KPF 17.11.2022	24.11.2022	
3.							
4.							
5.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2022
DHJETOR 2022

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETE T Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Plani i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2022	Kryetari i Komunës	Kuvendi i Komunës	09.12.2022	KPF 16.12.2022	23.12.2022	
2.	Plani i Punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2022	Drejtoritë përkatëse	Kryetari i Komunës	09.12.2022	KPF 16.12.2022	23.12.2022	
3.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	09.12.2022	KPF 16.12.2022	23.12.2022	
4.							
5.							

Kuvendi i Komunës së Drenasit ka planifikuar që gjatë vitit 2022, të mbaj gjithsej 11 mbledhje, këtë Plan i bashkëngjisim edhe orarin e takimeve që do të mbahen për secilin muaj.



DRENAS – 30.12.2021



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Ne mbështetje të ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L- 040, Statutit të Komunës dhe Rregullores për punën e kuvendit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2022, planifikon këtë:

Orari i seancave të Komitetit për politik dhe financa dhe i seancave të KK –al për vitin 2022

Janar Seanca e KPF-a me 19.01.2022 ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 26.01.2022 E Mërkurë	Shkurt Seanca e KPF-a me 16.02.2022 ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 23.02.2022 E Mërkurë	Mars Seanca e KPF-a me 17.03.2022 ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 24.03.2022 E Enjte
Prill Seanca e KPF-a me 20.04.2022 ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 27.04.2022, E Mërkurë	Maj Seanca e KPF-a me 19.05.2022, ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 26.05.2022 E Mërkurë	Qershor Seanca e KPF-a me 22.06.2022, ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 29.06.2022 E Mërkurë
Korrik Seanca e KPF-a me 20.07.2022, ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 27.07.2022, E Mërkurë	Gusht Pushim	Shtator Seanca e KPF-a me 21.09.2022, ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 28.09.2022, E Mërkurë
Tetor Seanca e KPF-a me 19.10.2022 ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 26.10.2022, E Mërkurë	Nëntor Seanca e KPF-a me 17.11.2022, ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 24.11.2022, E Enjte	Dhjetor Seanca e KPF-a me 16.12.2022, ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 23.12.2022, E Marte

Me date 30.12.2021



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Milaim Haidari